



SBASHK Arsimimi sot

Gusht, 2023

Gazeta elektronike

Takimi me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve Debat përmbajtjesor për çështje aktuale në arsimin e Kosovës



Në sallën e takimeve të Qendrës së Studentëve është mbajtur takimi i rregullt i SBASHK-ut me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve. Në këtë takim tema kyçe të bashkëbisedës ishin përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor, mungesa e dialogut social MASHTI- SBASHK me fajin e Ministrisë dhe diskutim për organizimin e takimeve me veprimtarët sindikalë e me anëtarësinë në të shtatë qendrat e Kosovës.

Në hapje të këtij takimi kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj... (faqe 4)

SBASHK-u u solidarizua me minatorët e Trepçës
E tmerrshme nëse ndëshkohen materialisht minatorët grevistë

Krahas shumë angazhimeve në shërbim të anëtarësisë dhe arsimit në Kosovë, SBASHK-u vazhdon të jetë... (faqe 7)

Bisedë me kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj

Viti i ri shkollor me probleme që kanë mundur të mos ndodhin



Punëtorët e arsimit dhe nxënësit vazhdojnë ... (faqe 3)

Kryetari dhe deputeti i AAK-së Ramush Haradinaj vizitoi SBASHK-un

Bashkëbisedë për sfidat e fillimit të vitit të ri shkollor



Kryetari i AAK-së dhe deputeti Ramush... (faqe 5)

SBASHK ka kritikuar vendimin e MASHTI-t për tekstet shkollore

Vendim i gabuar që krijon probleme që në fillim të vitit shkollor



Shumë çështje SBASHK do... (faqe 6)



Editorial

Ju kam thënë se Kurti e Nagavci janë pikëlluar pse nuk ka grevë në arsim



Kur u deklarova publikisht se viti shkollor 2023/2024 do të nis pa greva dhe se prindërit dhe qytetarët do të gëzohen, por jo edhe Kryeministri Kurti e Ministria Nagavci disa ushtarë në rrjete sociale dolën me atë fjalorin e tyre të ulët ndaj meje. Por, kjo çështja e teksteve shkollore dhe mungesa e tyre e tregoi se unë kam pasur të drejtë.

Ministria Nagavci pasi me gjithë stafin e saj nuk arriti të siguroj, jo laptop, projektorë e digjitalizim shkollash, por as tekste shkollore, që ishin dikur mjeti i vetëm i punës në shkolla bashkë me të nderuarit shkumësa e të nderuarat shpuza e me tabelat, që janë të vjetra sa unë. Po të kishim shpallur grevë në SBASHK-u ministria sot para medieve do të dilte me lotin në sy për nxënësit e prindërit e duke na sharë e fyer neve të SBASHK-ut e duke i dhënë kështu sinjal ushtarëve në rrjetet sociale, kudo janë në Evropë, botë e Kosovë që të

fyejnë e na etiketojnë, sidomos mua, që po e dëmtojmë arsimin e Kosovës dhe po cenojmë të drejtën kushtetuese të fëmijëve. Por, ja grevë nuk ka dhe doli sheshit e vërteta nga MASHTI. Tekste shkollore nuk ka si dikur falas, madje as për nxënësit 1-5, por prindërit duhet t'i blejnë ato dhe të presin mëshirën e Hekuran Muratit që t'ua rimbursojë në e-Kosovën e famshme.

Nagavci dhe Qeveria Kurti duhet ta dinë se një numër i madh i familjeve në Kosovë jetojnë në kushte tepër të vështira ekonomike dhe se tekstet shkollore falas për ta kanë qenë ndihmesë e madhe. Tani, me shpikjen e re të ministres prindërit duhet të blejnë tekstet, që vetë Nagavci po thotë se kanë çmim të lartë, dhe të presin mëshirën e Hekuran Muratit e Nagavcit se kur do t'ua qesin ato para pasi të kenë aplikuar në të famshëm e-Kosova.

Në këtë situatë që është Ministria Nagavci do të ishte shumë e lumtur që të kishte greva në arsim e ta fshehte mungesën e teksteve shkollore, që janë mjeti i vetëm i punës në shkollat tona të shekullit 21.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: **Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)** përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Bisedë me kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj

Viti i ri shkollor me probleme që kanë mundur të mos ndodhin

Punëtorët e arsimit dhe nxënësit vazhdojnë rrugëtimin për njohuri të reja. Ky vit shkollor është pritur të fillonte pa ndonjë problem dhe të ketë rrjedhë të mbarë, por MASHTI solli një vendim tepër të gabuar lidhur me tekstet shkollore dhe kjo krijoi reagime të arsyeshme edhe nga SBASHK. Bisedojmë me kryetarin Jasharaj për këtë dhe për çështje të tjera që ndërlidhën me arsimin.



Kryetari Jasharaj rithekson se SBASHK me të drejt ka reaguar kundër vendimit të gabuar lidhur me tekstet shkollore. Lidhur me këtë problem që krijoi MASHTI dhe ministrja Nagavci ka pasur shumë reagime të arsyeshme e ndër to edhe nga sindikata jonë. Kam deklaruar edhe në mediet e nderuara se kjo është ide tepër e gabuar e ministres Nagavci. Ajo është deklaruar para medieeve se disa nga testet kanë çmime tepër të larta dhe se ajo po angazhohet ta ruaj buxhetin e shtetit e nga ana tjetër u thotë prindërve bleni ju fillimisht tekstet e pastaj Qeveria do të rimbursojë ato para pas aplikimit të e-Kosova. “Nagavci duhet ta di e në Kosovë një pjesë e madhe e familjeve kanë gjendje të vështirë ekonomike dhe prindërit do ta kenë shumë të vështirë të blejnë testet shkollore për gjithë fëmijët që kanë e të presin pastaj në mëshirën e Nagavcit e Muratit që t’u rimbursohen mjetet që kanë shpenzuar për blerjen e teksteve shkollore. Pse të bëjnë rimbursime e t’i vënë në siklet prindërit kur ato para të rimbursimit t’i përdorin për të blerë MASHTI tekste e për t’i shpërndarë në shkollat e Kosovës”, thotë Jasharaj.

Kryetari Jasharaj në këtë bisedë për gazetën “Arsimimi sot” kthen kujtesën edhe në çështje

të tjera duke u ndalur edhe në aktivitetet e SBASHK-ut e për të veçuar aktivitetin tradicional për organizimin e pushimeve për një numër të konsideruar të anëtareve e anëtarëve të SBASHK nga e tërë Kosova. “Ky aktivitet kishte rrjedhë të mbarë dhe kjo është rezultat i angazhimit të përkushtuar të koordinatorit për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, të gjithë stafit qendror, por edhe të kryetarëve të nivelit komunal sindikal e të universiteteve. Shpreh respekt meritore edhe për pronarin e Kompleksit hotelier “Bonita” për të punësuarit aty, por edhe për pushuesit, të cilët kanë prezantuar me dinjitet figurën e punëtorit arsimor”, flet me krenari Jasharaj. Ai tregon edhe për takimin e mbajtur me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve dhe falënderon mediet për pjesëmarrjen në këtë takim dhe për korrektësinë e tyre në përcjelljen e angazhimeve e aktivitetëve të SBASHK.

Gjatë muajit

Takimi me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve **Debat përmbajtjesor për çështje aktuale në arsimin e Kosovës**

Në sallën e takimeve të Qendrës së Studentëve është mbajtur takimi i rregullt i SBASHK-ut me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve. Në këtë takim tema kyçe të bashkëbisedës ishin përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor, mungesa e dialogut social MASHTI- SBASHK me fajin e Ministrisë dhe diskutim për organizimin e takimeve me veprimtarët sindikalë e me anëtarësinë në të shtatë qendrat e Kosovës.



Në hapje të këtij takimi kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj është shprehur: “Të nderuara kolege, të nderuar kolegë, anëtarë të kryesisë dhe stafit ju përsëndes. Të nderuara medie, si gjithmonë, edhe sot, shpreh respekt të lartë e meritore në emër të SBASHK-ut për punën tuaj dhe korrektësinë në informim të opinionit për angazhimet e SBASHK -ut në shërbim të arsimit dhe anëtarësisë.



Të nderuar pjesëmarrës të këtij takimi, ndjehemi të lumtur që ky vit shkollor po fillon pa greva e veprime sindikale dhe kjo duhej ta gëzonte edhe Qeverinë, e veçmas ministren Nagavci, por duket se më shumë do t'i gëzonte greva për ta drejtuar gishtin drejt nesh e për t'u heshtur lëshimet e mungesa e përgatitjeve që MASHTI është dashur t'i bënte. Ky vit shkollor do të fillojë i

përcjellë me vështirësi, të cilat i krijoi MASHTI me eksperimentin e gabuar për tekstet shkollore. Përgëzojmë DKA-të dhe institucionet komunale në përgjithësi për angazhimin dhe për përgatitjet e bëra me kohë në bazë të mundësive lidhur me vitin e ri shkollor”, ka deklaruar Jasharaj për të shtuar se MASHTI në vend që të jetë shembull i angazhimit për trajnimin dhe ngritjen e vazhdueshme profesionale, pengon sepse që në prill Këshilli Shtetëror i Licencimit të Mësimdhënësve kishte vendosur të publikohet thirrja për aplikim për trajnime të reja dhe pas propozimit të SBASHK kishte vendosur që organizatat që janë duke mbajtur trajnime të vazhdojnë derisa nuk do të bëheshin aplikimet dhe përzgjedhja e radhës për trajnime, por ministria Nagavci dhe kabineti i saj e hodhën poshtë këtë vendim duke penguar kështu edhe këtë aktivitet tepër më rëndësi. Gjithë këto sfida e probleme po ndodhin me fajin e MASHTI-t që i ik takimeve e bashkëbisedave me ne dhe me palët tjera, që janë të ndërlidhura me arsimin dhe sjell vendime të njëanshme e pa konsultime, që do duhej bërë.



Në pjesën e parë të takimit duke shprehur shqetësimin e arsyeshëm për vendimin e gabuar të MASHTI-it lidhur me tekstet shkollore dhe konkretisht edhe për vendimin që të bëhet aplikim në e-Kosova me qëllim që të bëhet rimbursim mjeteve në llogari të prindërve për blerjen e teksteve shkollore dhe mjeteve mësimore për klasat 1-5, koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri e ka vlerësuar me të drejtë e duke afuar argumente këtë proces të komplikuar dhe vështirë të realizueshëm e duke e argumentuar me problemet e lëshimit në këtë platformë lidhur me vendimin skandaloz të ministrit Murati që anëtarësia sindikale të regjistrohet në e-Kosova.



Pas kësaj shumë nga kryetarët duke u kyçur në bashkëbisedë kanë raportuar për situatën aktuale dhe përgatitjet e bëra në komunat e tyre për vitin e ri shkollor. Ata kanë theksuar se institucionet komunale dhe organet udhëheqëse e bashkë me punëtorët arsimor kanë bërë përgatitje me kohë, brenda mundësive, për fillim të mbarë të vitit të ri shkollor, por shqetësime të mëdha e kritika të shumta janë ngritur ndaj vendimit të paqëlluar të ministres Nagavci lidhur me tekstet

Kryetari dhe deputeti i AAK-së Ramush Haradinaj vizitoi SBASHK-un **Bashkëbisedë për sfidat e fillimit të vitit të ri shkollor**

Kryetari i AAK-së dhe deputeti Ramush Haradinaj bashkë me shefin e grupit Parlamentar të këtij subjekti politik Besnik Tahiri dhe eksperti i ekonomisë Haki Shatri kanë vizituar selinë e SBASHK-ut për të bashkëbiseduar me kryetarin Rrahman Jasharaj, nënkryetaren Vjollca Shala e me koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri lidhur me sfidat dhe gjendjen aktuale në arsim duke u fokusuar te problemi i krijuar nga MASHTI për tekstet shkollore.



Kryetari Jasharaj ka falënderuar z. Haradinajn për vizitën duke u shprehur se punëtorët e arsimit të viteve të 90-ta i janë mirënjohës për gjithë angazhimet kur Haradinaj ishte Kryeministër lidhur me Ligjin për statusin e

shkollorë. Në kuadër të këtij takimi nënkryetaria Vjollca Shala ka zhvilluar bashkëbisedë me pjesëmarrësit për organizimin e takimeve me veprimtarët sindikalë e me anëtarësinë në pesë qendra të Kosovës, aktivitet ky që do të zhvillohet në bashkëpunim me Qendrën Amerikane të Solidaritetit me seli në Tiranë.



Pas diskutimeve u mor vendimi që ky aktivitet të zhvillohet në të shtatë qendrat e mëdha, porse në to do të marrin pjesë përfaqësues sindikal nga të gjitha komunat e Kosovës për të realizuar kështu 7 tryeza tematike me veprimtarë sindikalë. Mediet i kanë dhënë rëndësi të madhe dhe hapësirë meritore këtij takimi në SBASHK.

punëtorëve të arsimit shqip për vitet e 90-ta. Jasharaj bashkë me nënkryetaren Shala dhe koordinatoren për organizim të brendshëm kanë shpalosur vlerësimet që janë bërë në takimin në SBASHK nga kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të universiteteve lidhur me veprimin e gabuar të MASHTI-t për tekstet shkollore, veprim ky që ka krijuar stres e shqetësime te prindërit, por edhe të punëtorët arsimor, të cilët kanë frikë se fillimi i vitit shkollor nuk do të ketë rrjedhë të mbarë sepse mund të shkojnë shumë ditë derisa nxënësit të pajisen me tekste shkollore.



Kryetari i AAK-së dhe deputeti Ramush Haradinaj është shprehur se qëllimi i kësaj vizite është që ta uroj anëtarësinë e SBASHK-ut për fillimin e vitit të

ri shkollor dhe të dëgjojë nga afër për shqetësimet që përfaqësuesit e të punësuarve në arsim kanë ngritur lidhur me përgatitjet për vitin e ri shkollor e veçmas për problemin e krijuar pa arsye nga MASHTI për tekstet shkollore. Jasharaj ka lutur deputetët Haradinaj e Tahiri që bashkë me deputetët tjerë të opozitës, por edhe me ata të subjektit politik që ka shumicën në parlament, që të vazhdojnë angazhimet me qëllim që vlera e koeficientit të ngritet sepse vlera e tanishme prej 105 euro nuk ka realizuar pritjet dhe se edhe në sektorin e arsimit, por edhe në polici e sektorë të tjerë të punësuarit janë të zhgënjyer me atë që u ka sjellë Ligji i pagave. Kryetari dhe deputeti i AAK-së Ramush Haradinaj dhe kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj pas këtij takimi u janë drejtuar medieve me vlerësimin e këtij takimi dhe u janë përgjigjur edhe shumë pyetjeve të gazetarëve.



SBASHK ka kritikuar vendimin e MASHTI-t për tekstet shkollore **Vendim i gabuar që krijon probleme që në fillim të vitit shkollor**

Shumë çështje SBASHK do t'i debatonte në takimet që do të duhej të mbaheshin në MASHTI, por Ministria Nagavci vazhdon t'i ikë këtyre takimeve sepse ende nuk i ka ikur mllëfi e inati për grevën e shtatorit të vitit të kaluar. Në këtë situatë SBASHK gjithë shqetësimet vazhdon t'i ngrit përmes reagimeve e deklarimeve në mediet e nderuara. Kështu ka vepruar SBASHK edhe lidhur me vendimin tepër të gabuar të MASHTI-t lidhur me tekstet shkollore, që vite me radhë dërgoheshin falas për nxënësit e Kosovës. Vendimin që këtë vit shkollor tekstet shkollore të shkojnë në librari e MASHTI pastaj të rimburojë mjetet në xhirollogaritë e prindërve që kanë aplikuar në e-Kosova, kryetari i SBASHK-ut e ka vlerësuar si të gabuar dhe si komplikim të radhës.




“Qeveria Kurti është dashur të gjejë buxhet për mjete bashkëkohore të punës arsimore me qëllim që shkollat tona të ecin me kërkesat e shekullit XXI, por nëse kjo nuk po ndodh, atëherë është dashur të sigurohet buxhet që të ketë tekste falas për të gjithë nxënësit nga klasa e parë e deri edhe në klasën e nëntë”, ka deklaruar Jasharaj. Kryetari i SBASHK-ut është deklaruar lidhur me këtë problem të krijuar në mediet e Kosovës duke shprehur edhe vlerësimin e anëtarësisë së SBASHK-ut, pra të punëtorëve të arsimit nga e tërë Kosova.

Ai ka shprehur shqetësim edhe lidhur me komplikimet dhe problemet me të cilat do të përballen prindërit gjatë përpjekjes për të aplikuar në platformën e-Kosova e pastaj edhe gjatë angazhimit për të blerë tekste në librari, të cilat në disa prej qytezave edhe mungojnë. “Prindërit do të përballen me telashet për aplikim, me telashet për të marrë paratë e rimbursimit e pastaj do të kenë telashe edhe për të blerë tekstet shkollore në librari, para të cilave mund të krijohen radhë në pritje. “Pasi që Qeveria paska mjete dhe do të rimburojë blerjen e teksteve, pse të ndodh kështu. Shumë më mirë do të ishte që me ato mjete të paguheshin shtëpitë botuese e tekstet të dërgoheshin në shkolla në mënyrë të organizuar e t'u shpërndaheshin nxënësve nga mësimdhënësit e tyre”, ka kritikuar Jasharaj për të shtuar se fatmirësisht nuk ka pasur kërkesa për veprime sindikale nga anëtarësia, pra nuk do të ketë grevë, por viti shkollor do të nis me probleme për shkak të mungesës së teksteve vonesës që do të ndodh deri sa nxënësit të kompletohen me tekste e mjete mësimore.

SBASHK-u u solidarizua me minatorët e Trepçës

E tmerrshme nëse ndëshkohen materialisht minatorët grevistë

Krahas shumë angazhimeve në shërbim të anëtarësisë dhe arsimit në Kosovë, SBASHK-u vazhdon të jetë shembull i shkëlqyer i solidaritetit me sindikatat tjera dhe del publikisht në mbështetje të kërkesave të tyre të drejta e legjitime duke apeluar që ato kërkesa të zgjidhen përmes dialogut e jo të ndodhin ndëshkime ndaj sindikalistëve, që në mungesë të dialogut, detyrohen të marrin veprime sindikale.



SBASHK-u ka shprehur shqetësim publik ndaj informacionit se ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv në “Trepça” kishte marrë vendim skandaloz që të ndëshkojë 151 minatorë pse ata paskan bërë grevë të arsyeshme sepse u janë vonuar pagat me të cilat ata

mbajnë familjet, paga këto që i fitojnë me shumë mund e sakrifica e duke u përballur me të papriturat që vijnë në thellësitë e tokës.

“E gjithë anëtarësia e SBASHK-ut solidarizohet fuqishëm me minatorët e gjigantit “Trepça” dhe i drejtohet z.Enisit që të mos e vë në jetë këtë ndëshkim. Ai duhet të kujtojë të tashmen, por edhe të kaluarën dhe historinë e ndritshme të minatorëve të Trepçës, që me sakrificë sublime e me grevën madhështore dikur ndihmuan që historia e Kosovës të ndërrojë kahe për të mirë. Solidarizohemi me këta minatorë që shefi dashka t’i ndëshkojë e t’i frikësojë që në të ardhmen mos të guxojnë as të përmendin fjalën grevë, por minatorët nuk janë frikësuar kurrë e nga askush. Solidarizohemi se edhe neve punëtorëve të arsimit u munduan të na frikësojnë me ndalje të mëditjes e të pagës vetëm pse ishim në grevën e lejuar me Ligj e të mbrojtur edhe me Kushtetutë. Ftojme Ushtruesin e detyrës së kryeshefit ekzekutiv në “Trepça” që të heq dorë nga kjo ide e ndëshkimit të padrejtë ndaj minatorëve grevist”, është thënë në reagimin publik të SBASHK-ut, që është publikuar në medie.


Një aktivitet i veçantë i SBASHK-ut bashkë me Qendrën Amerikane të Solidaritetit Përgatitje e veprimtarëve sindikalë për t’u përballur me sfidat e kohës

SBASHK dhe Qendra Amerikane e Solidaritetit me seli në Tiranë vazhdojnë angazhimet e përbashkëta me qëllim të përgatitjes sa më të mirë të veprimtarëve sindikal në përballje me sfidat e shumta të kohës. Rezultat i këtij bashkëpunimi është edhe përgatitja e përbashkët për organizimin e një aktiviteti të veçantë me 100 veprimtarë sindikal të përzgjedhur nga arsimit parauniversitar dhe universitetet.

Për përgatitjen dhe rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti nga SBASHK janë angazhuar nënkryetarja Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, të cilët të ndihmuar nga stafi qendror dhe kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të universiteteve do të përkujdesen për rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti, që do të organizohet në shtatë qendrat e mëdha të Kosovës me pjesëmarrjen e veprimtarëve sindikalë të përzgjedhur nga të gjitha komunat e Kosovës dhe Universitetet.

Lidhur me përgatitjet e bëra deri tani për këtë aktivitet i ka informuar gjatë takimit të 28 gushtit nënkryetarja Vjollca Shala duke përmendur edhe datat e mundshme për zhvillimin e këtij aktiviteti e duke shtuar se në këto punëtori do të marrin pjesë dhe do të japin kontribut të çmuar edhe përfaqësues nga zyra në Tiranë e Qendrës

Amerikane të Solidaritetit. Kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të universiteteve e kanë vlerësuar si të qëlluar këtë aktivitet, por kanë kërkuar që të fillohet në muajin tetor ngase, siç thanë ata, muaji shtator mund të jetë plot me sfida për shkak të problemit të krijuar nga MASHTI lidhur me tekstet shkollore.



Urimi i SBASHK-ut për punëtorët e arsimit dhe nxënësit

Urime viti i ri shkollor

Të nderuar anëtarë të SBASHK-ut duke ju uruar juve dhe gjithë nxënësve për vitin e ri shkollor ju falënderoj që kësaj radhe nuk kishit kërkesa për veprime sindikale dhe kjo na jepte shpresë se ky vit shkollor do të ketë fillim dhe rrjedhë të mbarë, por MASHTI u kujdes që kjo të mos ndodh duke sjell vendim të gabuar për tekstet shkollore, vendim ky që ka krijuar shqetësime e stres të punëtorët arsimorë në mësimin shqip, por dhe te kolegët tanë në mësimin në gjuhën boshnjake e turke.



PERISKOP.COM

SBASHK uron vitin e ri shkollor, ka një paralajmërim për Nagavcin

Në reagimin e tyre sërish kanë theksuar se MASHT-i ka bërë vendim të gabuar për tekstet shk...

Të nderuarit mësimdhënës të Kosovës ju keni qenë të përkushtuar në misionin e shenjtë të edukimit e arsimit të brezave nëpër vite e dekada dhe keni kaluar me sukses pengesat që na krijuan të tjerët. Ju lus që të angazhoheni maksimalisht e të kontribuoni aq sa mundeni që pajisja me tekste shkollore të bëhet në mënyrën më të mirë të mundur e sidomos për nxënësit që vijnë nga familje me gjendje më të rënduar ekonomike.



ZERI.INFO

"Ka tendenca të përçarjes", SBASHK-u i reagon Nagavcit pasi tha se nuk e di interesat e kujt i përfaqëson Jasharaj

Anëtare e anëtarë të SBASHK-ut Ministrija Nagavci, në vend që të kërkojë falje nga prindërit, nxënësit e mësimdhënësit për problemin që ka krijuar lidhur me tekstet shkollore, ajo kishte bërë pyetje se kë përfaqëson Jasharaj. Ajo, si duket, ka besuar se do të jep rezultate plani i saj dhe i ministrit Murati se duke krijuar

pengesa, që nuk ndodhin në asnjë vend demokratik të botës, punëtorët e arsimit nuk do të regjistrohen si sindikalistë në e-Kosova dhe kështu do të shuhet SBASHK-u. Por, Nagavci nuk ia paskan treguar lajmin se SBASHK-u nuk u shua, por vazhdon rrugëtimin me unitet të plotë e me shumë angazhime në shërbim të arsimit dhe do ta ngrit zërin në emër të anëtarësisë. Pra, Jasharaj përfaqëson mijëra e mijëra anëtare e anëtarë të SBASHK-ut që nga çerdhet e deri në universitete. Zonja Nagavci me tendencën për të krijuar përçarje deklarohet se ky vendimi i ri për tekstet shkollore qenka edhe në shërbim të mësimdhënësve. Ajo, mbase ka menduar se kështu i kursen nga lodhja e ndarjes se teksteve shkollore për nxënësit e tyre, por ata nuk e duan këtë kujdes sepse me kënaqësi e të lumtur e kanë kryer këtë veprim duke i parë të gëzuar nxënësit për tekstet e reja shkollore. Sa është kujdesur e kujdeset Nagavci për punëtorët e arsimit u pa kur i gëzohej angazhimit të Qeverisë për ndëshkim me ndalim pagash pse punëtorët e arsimit kishin qëndruar arsyeshëm në grevë. Dhe kur u bënte presion edhe me inspektorë që të mbajnë mësim për të kompensuar orët e humbura në grevë.



TELEGRAFI.COM

"Ka tendenca të përçarjes", SBASHK i reagon Nagavcit pasi tha se nuk e di interesat e kujt i përfaqëson Rrahman Jasharaj

Ministre mos u mundoni kot se sindikatën tonë u munduat ta shuani, por SBASHK ishte dhe mbetet sindikatë e punëtorëve të arsimit që nga çerdhet e deri në universitete dhe do të vazhdojë të jetë zë i tyre sepse ata janë bashkë e në SBASHK.